



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Puniljena / Prodato Received / Delivered	05-08	2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org / Unit	In Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKOPJEN	4553/2022		1/4	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.826/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti -kryetar, Ardita Haxhnikaj dhe Jeton Koca -anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2589/2021 i datës 22.06.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.826/2021 të datës 21.09.2021 e parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.826/2021 të datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i caktuar në pozitën e punës Udhëheqës i sektorit fitosanitar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, me datë 21.09.2021 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4721/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 27.08.2021 i protokolluar me datë 30.08.2021 me nr.5525 të Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.09.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë. Ndërsa me datë 05.10.2021 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4911/2021 nga organi i punësimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.10.2021 përmes shkresës me numër të protokollit 5053/2021 e ka njoftuar ankuesin për pamundësinë e vendosjes lidhur me ankesën e datës 21.09.2021 për shkak të mungesës së kuorumit dhe të njëjtin e ka udhëzuar që t'i ndjek procedurën e përcaktuar me dispozitat e LKA-se. Ankuesi, kundër heshtjes administrative, me datë 04.11.2021 ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative përmes Aktgjykimit me numër A.nr.2589/2021 ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil që të shqyrtojë dhe të vendosë lidhur me ankesën e datës 21.09.2021 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4721/2022 të datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 17.05.2021 me numër protokollit 3656 kundër vlerësimit të Komisionit të vlerësimit dhe njoftimit të datës 11.05.2021; Formulari për vlerësimin individual të intervistës së kandidatëve të datës 06.05.2021; Vendimi i datës 24.05.2022 me nr.3797 për anulimin e konkursit me nr.reference RN00006557 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Sektorit për Inspektime"; Ankesa e datës 25.08.2021 me nr.5471 kundër vlerësimit të datës 18.08.2021 nga komisioni i vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë; Formulari për vlerësimin individual të intervistës së kandidatëve të datës 18.08.2021; Vendimi i datës 30.08.2021 me numër protokollit 5525 i Komisionit për vlerësim; E-mail zyrtar i datës 20.09.2021; E-mail zyrtar i datës 31.08.2021; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 05.10.2021 me numër protokollit 4911 /2021 bashkë me shkresat e lëndës; Kopja e konkursit e datës 16.07.2021-30.07.2021 me nr.reference RN00007178 për pozitën Udhëheqës i Sektorit për inspektime; Lista e aplikantëve ; Lista e shkurtër e datës 03.08.2021; Njoftimi i datës 11.08.2021; Vendimi i datës 16.08.2021 për themelimin e komisionit vlerësues për lëvizje brenda kategorisë; E-mail zyrtar i datës 16.08.2021; E-mail zyrtar i datës 17.08.2021; Njoftimi për përfundimin e procedurës për lëvizje brenda kategorisë; Njoftimi i datës 30.08.2021; e-mail zyrtar i datës 20.08.2021; Njoftimi i datës 15.10.2021 me numër protokollit 5053/2021 dhe Aktgjykimi A.nr.2589/2021 i datës 22.06.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, *sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton se Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë më datë 01.07.2022 ka publikuar njoftimin për shpalljen e konkursit me numër reference RN00007178 për pozitën Udhëheqës i Sektorit për inspektime, i hapur për aplikim nga data 16.07.2022 deri me datë 30.07.2022, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi. I njëjti është përfshirë në intervistë. Në bazë të Formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve, asnjë prej kandidatëve nuk ka arritur të marrë 60 pikë, e mbi këtë arsye Menaxheri i Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë me datë 30.08.2022 ka publikuar Njoftimin se procedura e konkurrimit sipas Konkursit me numër reference RN00007178 përfundon pa fitues.

Pas njoftimit të datës 20.08.2022 për Përfundimin e Procedurës për Lëvizje Brenda Kategorisë, ankuesi parashtron ankesë më datë 25.08.2022 me nr.5471 kundër vlerësimit të kandidatëve nga Komisioni Vlerësues ,ndërsa me datë 27.08.2022, Komisioni i Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar, me arsyetimin se intervista është zhvilluar bazuar në dispozitat e nenit 47 të Rregullores (QRK)Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Komisioni Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë nuk e ka vlerësuar drejtë, dhe procedura e konkurrimit është zhvilluar me tension dhe presion dhe me ndikim të zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Në bazë të konkursit me numër reference RN00007178 për pozitën Udhëheqës i Sektorit për Inspektime, kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë: - *Diplomë Universitare-Fakulteti i Bujqësisë dhe pesë(5) vite përvojë pune.* Në këtë kuptim, si dhe duke ju referuar provave të lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Komisioni i Vlerësimit vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrim, duke vepruar kështu në pajtim me nenin 47 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, rrjedhimisht Kolegji konstaton së është i pa bazuar pretendimi ankimor i ankuesit se Komisioni Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë ka bërë vlerësim jo të drejtë dhe tendencioz.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga analizimi i shkresave të lëndës ka vlerësuar se ankuesi me rastin e intervistimit ka arritur të marrë gjithsej 59.4 pikë dhe nuk ka arrit të jetë kandidati fitues duke kaluar pragun e pikëve të përcaktuara me nenin 49 paragrafi 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se *2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjatëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurrimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëmrisht. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjatëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues. Njësia Përgjegjëse publikon njoftimin për përfundimin e procedurës të konkurrimit pa fitues, në pajtim me nenin 49 paragrafi 3 të kësaj Rregulloreje.*

Bazuar në konstatimet si me lart, Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar ne nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.826/2021, datë 05.08.2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-gjyqtarit Ramush Bardiqi;
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së

